

KULTURNI PEJZAŽ

Segment Ulcinjske maslinade

SUVOZID

PEIZAZHI KULTUROR

Segment i Ullishtës së Ulqinit

MURI I THATË

MSJA

Ulcinj / Ulqin, 2026

www.msja.me

IMPRESUM

KONCEPT / KONCEPTI:

Dr Martin Schneider-Jacoby Assoc. - MSJA

KONTAKT / KONTAKTI:

Dr Martin Schneider-Jacoby Assoc. - MSJA
Ul. Pavla Kneževića br. 7, Pinješ 3,
85360 Ulcinj / Rr. Pavla Kneževića nr. 7, Pinjesh 3,
85360 Ulqin

info@msja.me
msja.zenepa@gmail.com

FB: <https://www.facebook.com/msja.mne/>
IG: https://www.instagram.com/msja_mne/
YT: https://www.youtube.com/@msja_me
W: [Instagram:msja_me](https://www.instagram.com/msja_me)

GLAVNA I ODGOVORNA UREDNICA REDAKTORE PËRGJEGJËSE:

Zenepa Lika - MSJA

SKICE / SKICAT:

Studija kulturnog pejzaža Ulcinjske maslinade i uvale
Valdanos (MSJA, 2023) / Studimi i Peizazhit Kulturor të
Ullishtës së Ulqinit dhe Gjirit të Valdanosit (MSJA, 2023)

Studenske skice Arhitekonskog fakultete
Podgorica, nastale u okviru Škole suvozida u maju 2026.g.
/ Skica të studentëve të Fakultetit të Arkitekturës në
Podgoricë, të realizuara në kuadër të Shkollës së murit të
thatë, maj 2026.

FOTOGRAFIJE / FOTOGRAFITË:

Arhiva MSJA (Škola suvozida, 8–10. maj 2026.) / Arkivi i
MSJA-së (Shkolla e murit të thatë, 8–10 maj 2026)

Zenepa Lika

DIZAJN / DIZAJNI:

Adelina Sejdić

ŠTAMPA / SHTYPI:

Golbi Doo, Podgorica / Podgoricë

TIRAŽ / TIRAZHI:

150 komada / 150 copë

MSJA



Izrada brošure "Kulturni pejzaž suvozidi Ulcinjske maslinade" je nastala u okviru projekta "Kreativni čuvari i glas zajednice za prirodno i kulturno nasljeđe Ulcinja", koji realizuje Društvo „Dr Martin Schneider-Jacoby Assoc – MSJA“, a finansira **Evropska fondacija za demokratiju - EED**.

Izneseni stavovi i mišljenja pripadaju isključivo autorima i ne odražavaju nužno stavove donatora.

Broshura "Peizazhi kulturor – muret e thata të Ullishtës së Ulqinit" është përgatitur në kuadër të projektit "Ruajtësit kreativë dhe zëri i komunitetit për trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Ulqinit", i cili zbatohet nga Shoqata "Dr Martin Schneider-Jacoby Association – MSJA" dhe financohet nga **Fondacioni Evropian për Demokraci (EED)**.

Qëndrimet dhe opinionet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi ekskluzive e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit.




Autor skice / Autori i skicës: Veljko Nikčević
student AF - Škola suvozida, Ulcinjska maslinada u maju .2026.g. / student i FA, Shkolla e murit të thatë, Ullishta e Ulqinit, maj 2026.

Veljko Nikčević

Maj, 2026

ŠKOLA SUVOZIDA



! KREĆENJE TERENA U
CILJU STVARANJA
OBRADIVE PLOŠTINE.



* KUĆE, KOLI BE, ČESME

* PODZIDI



* URLOVI

SUVOZIDI ZA VODU



* GUMNA



UVOD
HYRJE

Kulturni pejzaž Ulcinjske maslinade rezultat je vjekovnog zajedničkog djelovanja čovjeka i prirode, znanja koje se prenosilo generacijama i pažljivog oblikovanja prostora u skladu sa njegovim prirodnim karakteristikama. Terasa, suvozidni podzidi, staze, odvodni kanali i česme nijesu samo elementi jednog pejzaža – oni predstavljaju svjedočanstvo načina života, rada i odnosa prema prostoru koji je oblikovao identitet Ulcinja.

Suvozid nije samo kameni zid. On je granica i veza, zaštita tla i trag ljudskog rada. Vjekovima oblikuje terasasti pejzaž Ulcinjske maslinade, čuvajući maslinjake, usmjeravajući vodu i svjedočeći o skladnom odnosu čovjeka i prirode. Upravo zahvaljujući suvozidima nastao je jedinstveni kulturni pejzaž koji danas prepoznajemo kao jedno od najvrjednijih područja juga Crne Gore. Međutim, suvozid je mnogo više od tradicionalne tehnike gradnje kamenom bez vezivnog materijala. On predstavlja način opremanja zemljišta koji omogućava njegovo održivo korišćenje i prilagođavanje prirodnim karakteristikama prostora. Kao podzid terase, međa između parcela ili potporni zid, suvozid štiti tlo od erozije, reguliše odvod vode, omogućava obradu maslinjaka i stvara staništa za brojne biljne i životinjske vrste. U njemu su istovremeno sačuvani znanje, iskustvo i mudrost generacija koje su oblikovale ovaj prostor.

Ova publikacija nastala je kao nastavak prve Škole suvozida, koju je organizovala Dr Martin Schneider-Jacoby Association – MSJA od 8. do 10. maja 2026. godine u Ulcinjskoj maslinadi. Škola je okupila lokalne majstore, stručnjake, studente i mlade sa zajedničkim ciljem da tradicionalna znanja ostanu živa i budu prenesena budućim generacijama. Namjera ovog publikacijaa nije da bude tehnički vodič za gradnju suvozida. Njegova svrha je da posluži kao uvod u razumijevanje i prepoznavanje suvozida kao jednog od ključnih segmenata kulturnog pejzaža Ulcinjske maslinade, njegove vrijednosti, brojnih funkcija i značaja za očuvanje autentičnosti ovog jedinstvenog prostora.

Vjerujemo da očuvanje kulturnog pejzaža nije moguće bez očuvanja znanja koja su ga oblikovala. Zato ovaj publikacija predstavlja poziv da naučimo da prepoznamo vrijednosti koje nas okružuju, da ih razumijemo i zajedno čuvamo za buduće generacije. Jer očuvanjem suvozida ne čuvamo samo kamen – čuvamo pejzaž, sjećanje i znanje utkano u svaki njegov pažljivo složeni kamen.





Peizazhi kulturor i Ullishtës së Ulqinit është rezultat i bashkëveprimit shekullor ndërmjet njeriut dhe natyrës, i dijes së transmetuar brez pas brezi dhe i formësimit të kujdesshëm të hapësirës në përputhje me karakteristikat e saj natyrore. Tarracat, muret mbajtëse me gur të thatë, shtigjet, kanalet kulluese dhe krojet nuk janë vetëm elemente të një peizazhi ato janë dëshmi e mënyrës së jetesës, punës dhe marrëdhënies me hapësirën që ka formësuar identitetin e Ulqinit.

Muri i thatë nuk është thjesht një mur prej guri. Ai është njëkohësisht kufi dhe lidhje, mbrojtje e tokës dhe gjurmë e punës së njeriut. Për shekuj me radhë ai ka formësuar peizazhin me tarraca të Ullishtës së Ulqinit, duke mbrojtur ullishtat, duke drejtuar rrjedhën e ujit dhe duke dëshmuar për bashkëjetesën harmonike ndërmjet njeriut dhe natyrës. Pikërisht falë këtyre mureve me gur të thatë është krijuar peizazhi unik kulturor, të cilin sot e njohim si një nga zonat më të vlefshme të jugut të Malit të Zi.

Megjithatë, muri me gur të thatë është shumë më tepër sesa një teknikë tradicionale ndërtimi me gurë pa përdorimin e materialeve lidhëse. Ai përfaqëson një mënyrë të organizimit dhe sistemimit të tokës, që mundëson shfrytëzimin e saj të qëndrueshëm dhe përshtatjen me veçoritë natyrore të terrenit. Si mur mbajtës i tarracave, kufi ndërmjet parcelave apo mur mbështetës, ai mbron tokën nga erozioni, rregullon largimin e ujërave, mundëson kultivimin e ullishtave dhe krijon habitate për një numër të madh specimesh bimore dhe shtazore. Në të ruhen njëkohësisht dija, përvoja dhe urtësia e brezave që kanë formësuar këtë hapësirë.

Ky manual është hartuar si vazhdim i Shkollës së parë të murit të thatë, të organizuar nga Dr Martin Schneider-Jacoby Association – MSJA, e cila u mbajt nga 8 deri më 10 maj 2026 në Ullishtën e Ulqinit. Shkolla mbledhi mjeshtër vendas, ekspertë, studentë dhe të rinj me një qëllim të përbashkët që njohuritë tradicionale të mbeten të gjalla dhe t'u transmetohen brezave të ardhshëm.

Qëllimi i këtij manuali nuk është të jetë një udhëzues teknik për ndërtimin e mureve me gur të thatë. Synimi i tij është të shërbejë si hyrje në kuptimin dhe njohjen e murit me gur të thatë si një nga elementet themelore të peizazhit kulturor të Ullishtës së Ulqinit, duke vënë në pah vlerat e tij, funksionet e shumta dhe rëndësinë që ka për ruajtjen e autenticitetit të këtij peizazhi të veçantë.

Ne besojmë se ruajtja e peizazhit kulturor nuk është e mundur pa ruajtjen e dijes që e ka formësuar atë. Prandaj, ky manual është një ftesë për të mësuar të njohim vlerat që na rrethojnë, t'i kuptojmë ato dhe t'i ruajmë së bashku për brezat që do të vijnë. Sepse duke ruajtur muret me gur të thatë, nuk ruajmë vetëm gurin – ruajmë peizazhin, kujtesën dhe dijen e gdhendur në çdo gur të vendosur me kujdes.

SADRŽAJ / PËRMBAJTJA

Vjekovi čovjeka, masline i kamena.....	01
Shekujt e njeriut, ullirit dhe gurit.....	02
Suvozid – temelj terasastog pejzaža.....	04
Muri i thatë – themeli i peizazhit me tarraca.....	05-06
Više od kamenog zida.....	07
Më shumë se një mur guri.....	08
Lice Ulcinjske maslinade /	
Fytyra e Ullishtës së Ulqinit.....	09-14
Škola suvozida – znanje se čuva praksom.....	15
Shkolla e murit të thatë – Dija ruhet përmes praktikës.....	16
Pro memoria - Tanja Vujović, etnološkinja.....	17-18
Pro memoria - Tanja Vujović, etnologue.....	21-22



Autorka skice / Autore i skicës: Jovana Perović
studentkinja AF - Škola suvozida, Ulcinjska maslinada u maju .2026.g.
/studente i FA, Shkolla e Murit të Thatë, Ullishta e Ulqinit, maj 2026.

KULTURNI PEJZAŽ

Segment Ulcinjske maslinade

SUVOZID

PEIZAZHI KULTUROR

Segment i Ullishtës së Ulqinit

MURI I THATË

Ulcinj / Ulqin, 2026

MSJA

ČOVJEK, MASLINA I KAMEN KROZ VJEKOVE

01

Ulcinjska maslinada sa uvalom Valdanos predstavlja jedan od najvrijednijih i najočuvanijih terasastih kulturnih pejzaža Mediterana u Crnoj Gori. Prostire se od grada Ulcinja do uvale Valdanos u dužini od oko pet kilometara, a njene terase, suvozidni podzidi, staze, odvodni kanali i česme svjedoče o viševjekovnom odnosu čovjeka i prirode.

Maslinada broji oko 80.000 stabala maslina, dok se u samoj uvali Valdanos nalazi više od 18.000 stabala, među kojima pojedina dostižu starost i preko 1900 godina. Pretpostavlja se da su prve masline na ovom prostoru zasadili Iliri, a njihov uzgoj nastavljen je kroz različite istorijske epohe, ostavljajući trajan pečat na identitet i način života lokalne zajednice.

Uvala Valdanos je kroz istoriju imala poseban značaj kao prirodna luka za brodove, zaštićena od gotovo svih vjetrova. Istovremeno, riječ je o bogatom arheološkom lokalitetu koji svjedoči o kontinuitetu života i pomorske tradicije ovog područja još od antičkog perioda.

Posebnu vrijednost Ulcinjske maslinade predstavlja njena prostorna cjelovitost i autentičnost. Ovaj pejzaž nije oblikovan samo sadnjom maslina, već i pažljivim opremanjem zemljišta – izgradnjom terasa i suvozidnih podzida, trasiranjem puteva i staza, uspostavljanjem sistema odvodnih kanala i izgradnjom česama koje su omogućavale održivo korišćenje prostora kroz vjekove.

Upravo zahvaljujući ovom skladnom odnosu čovjeka i prirode, Ulcinjska maslinada sa uvalom Valdanos danas je prepoznata kao područje izuzetnih kulturnih, prirodnih i pejzažnih vrijednosti, za koje je pokrenut proces zaštite kao kulturnog pejzaža.



NJERIU, ULLIRI DHE GURI NDËR SHEKUJ

Ullishta e Ulqinit me gjirin e Valdanosit përfaqëson një nga peizazhet kulturore me tarracat më të vlefshme dhe më të ruajtura të Mesdheut në Mal të Zi. Ajo shtrihet nga qyteti i Ulqinit deri në gjirin e Valdanosit, në një gjatësi prej rreth pesë kilometrash. Tarracat, muret mbajtëse prej guri të thatë, shtigjet, kanalet kulluese dhe burimet e ujit dëshmojnë për marrëdhënien shumë shekullore ndërmjet njeriut dhe natyrës.

Ullishta numëron rreth 80.000 rrënjë ullinjsh, ndërsa vetëm në gjirin e Valdanosit gjenden mbi 18.000 trungje, disa prej të cilave kanë një moshë mbi 1900 vjet. Besohet se ullinjtë e parë në këtë zonë janë mbjellë nga ilirët, ndërsa kultivimi i tyre ka vazhduar gjatë epokave të ndryshme historike, duke lënë një gjurmë të pashlyeshme në identitetin dhe mënyrën e jetesës së komunitetit lokal.

Gjatë historisë, gjiri i Valdanosit ka pasur një rëndësi të veçantë si port natyror për anijet, i mbrojtur nga pothuajse të gjitha erërat. Njëkohësisht, ai përbën një lokalitet të pasur arkeologjik që dëshmon për vazhdimësinë e jetës dhe traditës detare në këtë hapësirë që nga periudha antike.

Vlera e veçantë e Ullishtës së Ulqinit qëndron në tërësinë dhe autenticitetin e saj hapësinor. Ky peizazh nuk është formësuar vetëm përmes mbjelljes së ullinjve, por edhe falë sistemimit të kujdesshëm të tokës – ndërtimit të tarracave dhe mureve mbajtëse prej guri të thatë, hapjes së rrugëve dhe shtigjeve, krijimit të një sistemi kanalesh kulluese dhe ndërtimit të burimeve të ujit, të cilat kanë mundur shfrytëzimin e qëndrueshëm të kësaj hapësire ndër shekuj.

Pikërisht falë kësaj harmonie të rrallë ndërmjet njeriut dhe natyrës, Ullishta e Ulqinit me gjirin e Valdanosit njihet sot si një zonë me vlera të jashtëzakonshme kulturore, natyrore dhe peizazhore, për të cilën është iniciuar procesi i mbrojtjes si Peizazh Kulturor.





SUVOZID: TEMELJ TERASASTOG PEJZAŽA

„Suvozid je faza u osvajanju obradivog zemljišta, utvrđeni nasip za zaustavljanje prirodne erozije, međa između parcela, terasa, ograda, zaštita od životinja i vjetra, utočište za biljke i životinje i još mnogo toga.“

Izvod: Studija kulturnog pejzaža Ulcinjske maslinade i uvale Valdanos)

Bez suvozida ne bi postojala ni Ulcinjska maslinada kakvu danas poznajemo.

On je jedan od ključnih elemenata koji je omogućio nastanak i očuvanje ovog jedinstvenog terasastog pejzaža, oblikujući prostor u skladu sa njegovim prirodnim karakteristikama i potrebama lokalne zajednice.

Suvozid nije samo tradicionalna tehnika gradnje kamenom bez vezivnog materijala, već predstavlja i način opremanja zemljišta koji omogućava njegovo održivo korišćenje vjekovima.

Zajedno sa terasama, stazama, odvodnim kanalima, putevima i česmama čini jedinstven sistem koji omogućava zaštitu tla od erozije, pravilno upravljanje vodom, pristup maslinjacima i njihovo dugoročno održavanje.

U Ulcinjskoj maslinadi suvozid ima višestruku ulogu, on pridržava terase, definiše granice parcela, štiti zemljište i predstavlja stanište brojnim biljnim i životinjskim vrstama. Istovremeno, suvozid svjedoči o znanju i umijeću generacija koje su, poštujući prirodne karakteristike prostora, stvorile kulturni pejzaž izuzetne vrijednosti.

Posmatrati suvozid samo kao kameni zid značilo bi zanemariti njegovu istinsku vrijednost. Suvozid je temelj terasastog pejzaža Ulcinjske maslinade, mjesto susreta čovjeka, prirode, znanja i vremena.

MURI I THATË: THEMELI I PEIZAZHIT ME TARRACA

05

Muri i thatë është një fazë në përvetësimin e tokës bujqësore, një pritë e ndërtuar për të ndaluar erozionin natyror, kufi ndërmjet parcelave, tarracë, gardh, mbrojtje nga kafshët dhe era, strehë për bimët dhe kafshët, si dhe shumë më tepër."

Burimi: Studimi i peizazhit kulturor të Ullishtës së Ulqinit dhe Gjirit të Valdanosit

Pa muret e thata, Ullishta e Ulqinit nuk do të ekzistonte në formën që e njohim sot.

Ato janë një nga elementet themelore që kanë bërë të mundur krijimin dhe ruajtjen e këtij peizazhi unik me tarraca, duke formësuar hapësirën në harmoni me karakteristikat natyrore të terrenit dhe nevojat e komunitetit lokal.

Muri i thatë nuk është vetëm një teknikë tradicionale ndërtimi me gurë, pa përdorimin e llaçit apo materialeve lidhëse, por ai përfaqëson edhe një mënyrë të organizimit të tokës, e cila ka mundësuar shfrytëzimin e saj të qëndrueshëm për shekuj me radhë.

Së bashku me tarracat, shtigjet, kanalet kulluese, rrugët dhe burimet, ai përbën një sistem unik që mbron tokën nga erozioni, mundëson menaxhimin e duhur të ujit, siguron qasje në ullishte dhe garanton mirëmbajtjen e tyre afatgjatë.

Në Ullishtën e Ulqinit, muri i thatë ka një rol të shumëfishtë: ai mban tarracat, përcakton kufijtë e parcelave, mbron tokën dhe krijon habitat për shumë lloje bimësh dhe kafshësh. Njëkohësisht, ai dëshmon për dijen dhe mjeshtërinë e brezave që, duke respektuar veçoritë natyrore të këtij territori, krijuan një peizazh kulturor me vlera të jashtëzakonshme.

Ta shohësh murin e thatë vetëm si një mur prej guri do të thotë të mos e kuptosh vlerën e tij të vërtetë.

Muri i thatë është themeli i peizazhit me tarraca të Ullishtës së Ulqinit, është vendi ku takohen njeriu, natyra, dija dhe koha.



*Autorka skice / Autore i skicës: Jovana Perović
studentkinja AF - Škola suvozida, Ulcinjska maslinada u maju .2026.g. / studente i FA, Shkolla e murit të thatë, Ullishta e Ulqinit, maj 2026.*

Suvozid je neizostavni dio sistema koji više od dvije hiljade godina omogućava život i održivo korišćenje prostora Ulcinjske maslinade.

Muri i thatë përbën një element thelbësor të sistemit i cili, për më shumë se dy mijë vjet, ka mundësuar jetën dhe përdorimin e qëndrueshëm të peizazhit kulturor të Ullishtës së Ulqinit.

Suvozid je mnogo više od tradicionalne tehnike gradnje kamenom bez vezivnog materijala.

On je jedan od ključnih elemenata kulturnog pejzaža Ulcinjske maslinade i rezultat vjekovnog prilagođavanja čovjeka prirodnim karakteristikama prostora. Njegova vrijednost ogleda se u brojnim funkcijama koje zajedno omogućavaju očuvanje pejzaža, prirode i tradicionalnog načina života.

Štiti tlo od erozije

Suvozid stabilizuje teren i sprječava spiranje plodnog zemljišta usljed obilnih padavina i vjetra.

Reguliše odvod vode

Propusna struktura suvozida omogućava prirodno oticanje vode, smanjujući pritisak na teren i sprečavajući urušavanje terasa.

Omogućava formiranje terasa

Na strmim padinama upravo su suvozidni podzidi omogućili nastanak terasa pogodnih za uzgoj maslina.

Predstavlja među između parcela

Suvozid definiše granice posjeda i svjedoči o tradicionalnoj organizaciji prostora i međusobnom poštovanju vlasništva.

Omogućava uzgoj maslina

Bez suvozida ne bi bilo moguće dugoročno obrađivati veliki dio maslinjaka na zahtjevnom terenu.

Čuva biodiverzitet

Pukotine između kamenova predstavljaju sklonište brojnim biljkama, insektima, gmizavcima i drugim vrstama karakterističnim za mediteranski prostor.

Čuva tradicionalna znanja

Svaki suvozid nastaje zahvaljujući iskustvu i umijeću koje se vjekovima prenosilo sa generacije na generaciju.

Čuva identitet prostora

Suvozidi su jedan od najprepoznatljivijih simbola Ulcinjske maslinade i njenog kulturnog pejzaža.

MË SHUMË SE NJË MUR GURI

Muri i thatë është shumë më tepër sesa një teknikë tradicionale ndërtimi me gurë, pa përdorimin e materialeve lidhëse.

Ai është një nga elementët themelorë të peizazhit kulturor të Ullishtës së Ulqinit dhe rezultat i përshtatjes shumëshekullore të njeriut me karakteristikat natyrore të këtij territori. Vlera e tij qëndron në funksionet e shumta që së bashku mundësojnë ruajtjen e peizazhit, natyrës dhe mënyrës tradicionale të jetesës.

Mbron tokën nga erozioni

Muri i thatë stabilizon terrenin dhe pengon shpëlarjen e tokës pjellore nga reshjet e dendura dhe era.

Rregullon kullimin e ujit

Struktura e përshkueshme e murit të thatë lejon rrjedhjen natyrore të ujit, duke ulur presionin mbi terrenin dhe duke parandaluar shembjen e tarracave.

Mundëson krijimin e tarracave

Në shpatet e pjerrëta, pikërisht muret mbajtëse prej guri të thatë kanë bërë të mundur krijimin e tarracave të përshtatshme për kultivimin e ullinjve.

Shënon kufijtë e parcelave

Muri i thatë përcakton kufijtë e pronës dhe dëshmon organizimin tradicional të hapësirës, si dhe respektin e ndërsjellë për pronësinë.

Mundëson kultivimin e ullinjve

Pa muret e thata nuk do të ishte e mundur kultivimi afatgjatë i një pjese të madhe të ullishtave në këtë terren të vështirë.

Ruajnë biodiversitetin

Hapësirat ndërmjet gurëve shërbejnë si strehë për shumë lloje bimësh, insektesh, zvarranikësh dhe organizmash të tjerë karakteristike të rajonit mesdhetar.

Ruajnë dijet tradicionale

Çdo mur i thatë ndërtohet falë përvojës dhe mjeshtërisë që është përcjellë brez pas brezi për shekuj me radhë.

Ruajnë identitetin e peizazhit

Muret e thata janë një nga simbolet më të dallueshme të Ullishtës së Ulqinit dhe të peizazhit të saj kulturor.

Konzolne stepenice: Tradicionalno rješenje za kretanje između terasa različitih visina.

Shkallët konsolore: Zgjidhje tradicionale për lëvizjen ndërmjet tarracave me lartësi të ndryshme.



FYTYRA E ULLISHTËS SË ULQINIT

PODZID

Podzid je osnovni element terasastog pejzaža. Njegova uloga je da pridržava zemlju, omogućava formiranje terasa i štiti tlo od erozije. Upravo zahvaljujući podzidima moguće je obrađivati strme padine i sačuvati plodno zemljište.

MURI MBAJTËS

Muri mbajtës është elementi themelor i peizazhit të tarracuar. Roli i tij është të mbajë tokën, të mundësojë formimin e tarracave dhe ta mbrojë atë nga erozioni. Pikërisht falë mureve mbajtëse është e mundur të punohet në shpatet e pjerrëta dhe të ruhet toka pjellore.



MEĐA (KUFIN)

Međa ili **kufin** predstavlja tradicionalnu granicu između parcela. Osim što razdvaja posjede, ona svjedoči o istorijskom načinu organizacije prostora i dugotrajnom poštovanju vlasničkih odnosa u Maslinadi.

Na ovoj fotografiji posebno se vidi koliko je svaki element kulturnog pejzaža imao višestruku funkciju. Na prvi pogled riječ je o prolazu kroz maslinjak, ali ovaj prostor istovremeno predstavlja među (kufin) koja razdvaja parcele, kamenu stazu koja omogućava pristup višim terasama i maslinjacima, te odvodni kanal koji zahvaljujući blagom nagibu i kamenoj podlozi usmjerava površinske vode i štiti tlo od erozije.

Ovakva rješenja svjedoče o izuzetnom umijeću oblikovanja prostora, gdje nijedan element nije nastao slučajno. Svaki kamen imao je svoju namjenu, a zajedno su činili funkcionalan i održiv sistem koji je omogućavao život, rad i očuvanje Ulcinjske maslinade kroz vjekove.

KUFI

Kufi (megjë) përfaqëson kufirin tradicional ndërmjet parcelave. Përveç se ndante pronat, ai dëshmon mënyrën historike të organizimit të hapësirës dhe respektin shumë shekullor për marrëdhëniet pronësore në Ullishtën e Ulqinit.


Në këtë fotografi shihet qartë se çdo element i peizazhit kulturor kishte më tepër se një funksion. Në pamje të parë duket si një kalim përmes ullishtës, por në të njëjtën kohë kjo hapësirë përfaqëson kufirin ndërmjet parcelave, një shteg prej guri që mundëson qasjen drejt tarracave dhe ullishtave më të larta, por edhe një kanal kullues që, falë pjerrësisë së lehtë dhe bazës prej guri, drejton ujërat sipërfaqësore dhe mbron tokën nga erozioni.

Zgjidhje të tilla dëshmojnë mjeshtërinë e jashtëzakonshme në formësimin e hapësirës, ku asnjë element nuk ishte vendosur rastësisht. Çdo gur kishte funksionin e vet, ndërsa së bashku krijojnë një sistem funksional dhe të qëndrueshëm, i cili mundësoi jetën, punën dhe ruajtjen e Ullishtës së Ulqinit ndër shekuj.



POTPORNI ZID

Potporni zid obezbjeđuje stabilnost terasa i sprječava klizanje zemljišta. Njegova propusna konstrukcija omogućava prirodno oticanje vode i dugoročnu stabilnost terena.



MUR MBËSHTETËS

Muri mbështetës siguron stabilitetin e tarracave dhe parandalon rrëshqitjen e dheut. Struktura e tij e përshkueshme mundëson kullimin natyror të ujit dhe garanton stabilitetin afatgjatë të terrenit.

TERASE (SOFE)

Suvozidne terase, ili sofe, nastale su vještīm prilagođavanjem strmih padina uzgoju maslina. Osim što su omogućile obradu zemljišta i lakše kretanje kroz maslinjak, one su oblikovale jedinstven izgled Ulcinjske maslinade i danas predstavljaju prepoznatljivijih obilježja.

TARRACAT (SOFAT)

Tarracat, të njohura edhe si sofa, janë krijuar duke përshtatur relievin natyror me nevojat e njeriut. Ato mundësojnë kultivimin e ullinjve në shpatet e pjerrëta, lehtësojnë lëvizjen ndërmjet niveleve të ndryshme të terrenit dhe përbëjnë një nga elementët më karakteristikë të peizazhit kulturor të Ullishtës së Ulqinit.



ŠKOLA SUVOZIDA – ZNANJE SE ČUVA PRAKSOM



Otvaranje radnog kanala – priprema prostora za obnovu suvozida, Škola suvozida, Ulcinjska maslinada, 2026. Skica Zenepa Lika

Škola suvozida zamišljena je kao mjesto učenja kroz praktičan rad. Tokom tri dana, lokalni majstori, maslinari, stručnjaci, studenti Arhitektonskog fakulteta, predstavnici institucija i lokalne zajednice zajedno su učili kako se tradicionalno znanje gradnje suvozida može sačuvati i prenijeti novim generacijama.

Obnova počinje razumijevanjem zida i terena na kojem je nastao. Skica prikazuje jednu od prvih faza rada, tačnije priprema terena a to je otvaranje radnog kanala uz postojeći suvazid, kojim se obezbjeđuje prostor potreban za pristup zidu, uklanjanje nestabilnog materijala i njegovu pravilnu obnovu.

Škola zato nije bila samo radionica zidanja kamenom. Bila je prilika da se kroz zajednički rad razumije kako su suvozidi građeni, zašto su važni i kakvu ulogu imaju u očuvanju terasastog pejzaža Ulcinjske maslinade.

Jer tradicionalno znanje ostaje živo samo ako se prenosi i primjenjuje.

SHKOLLA E MURIT TË THATË – DIJA RUHET PËRMES PRAKTIKËS

Shkolla e murit të thatë është konceptuar si një hapësirë mësimi përmes punës praktike. Gjatë tri ditëve, mjeshtrit vendas, ullishtarët, ekspertët, studentët e Fakultetit të Arkitekturës, përfaqësuesit e institucioneve dhe komuniteti lokal mësuajnë së bashku se si njohuritë tradicionale të ndërtimit të mureve të thata mund të ruhen dhe t'u përcillen brezave të rinj.

Restaurimi fillon me njohjen dhe kuptimin e murit dhe terrenit në të cilin ai është ndërtuar. Skica paraqet një nga fazat e para të punës, hapjen e kanalit të punës përgjatë murit ekzistues, duke krijuar hapësirën e nevojshme për qasje në mur, largimin e materialit të paqëndrueshëm dhe restaurimin e tij në mënyrën e duhur.

Prandaj, Shkolla nuk ishte vetëm një punëtori për ndërtimin me gur. Ajo ishte një mundësi që, përmes punës së përbashkët, të kuptojmë si janë ndërtuar muret e thata, pse janë të rëndësishme dhe çfarë roli kanë në ruajtjen e peizazhit me tarraca të Ullishtës së Ulqinit.

Sepse dija tradicionale mbetet e gjallë vetëm nëse përcillet dhe zbatohet.



Hapja e kanalit të punës – përgatitja e hapësirës për restaurimin e murit të thatë, Shkolla e murit të thatë, Ullishta e Ulqinit, 2026.

Skicë: Zenepa Lika.

Prije skoro dvije hiljade godina zasađena je prva maslina na Valdanosu. Od maslina u ovom gradu, stariji je samo ulcinjski Stari grad. Više od šezdeset generacija Ulcinjana, preteča i predaka današnjih vlasnika sadilo je i održavalo svako stablo, svaki kazan i buljuk maslina, krčilo zemljište, planiralo sofe, gradilo suvomeđe, dubilo odvođe, čuvalo red i običaj u maslinjaku. Poslije su maslinjaci dobili šire, čistije i suve posalidžane puteve, popločane odvođe i česme zadužbinara. Svaka nova generacija nasljeđivala je prethodna znanja i umijeća i unapređivala ih novim. U zadnjih nekoliko decenija smo počeli zaboravljati i otanjili smo niti koje nas na dobar način povezuju sa najboljim dobrima i tekovinama našeg nasljeđa. Legendarni i vilinski ali i stvarni prostor Ulcinjske maslinade još drže kilometri starih puteva i staza, suvomeđa, podzida, kanala i salidža, načinjeni golim rukama i prostim alatom onih koji su nasljeđivali i prenosili potomcima znanje i umijeće njihove izrade i održavanja.

Tehnikom suvozida (gradnja kamenom bez vezivnog maltera) neobrađenim, pritesanim i klesanim kamenom građeni su brojni objekti u svim prošlim civilizacijama na crnogorskom i mediteranskom tlu, odnosno na svakom tlu koje obiluje kamenom, često i jednim građevinskim materijalom. Ta se tehnika gradnje najduže zadržala u gradnji jednodjelnih prizemnih kuća, koliba, stanova ili glada na katunima, pojata, hramova, drugih suvota i objekata. Oni i sad reprezentuju crnogorsko tradicionalno graditeljsko nasljeđe, kao i nadgrobni spomenici, guvna, bistijerne, uble, lokve, stepeništa i drugi privredni i pomoćni objekti. Tehnika suvozida je osobito praktikovana i nikad nije u potpunosti napuštena u gradnji puteva, međa, ograda, prolaza, mostova i drugih objekata neposredno vezanih za tradicionalni život i privređivanje.

Još 2019. dobijena je Inicijativa za zaštitu dobra Građenje suvomeđa. Od prihvatanja inicijative nije dalje odmicano jer nije bilo moguće navesti nosioce tradicije i praktikante živog nasljeđa dobra, koji to znanje prepoznaju kao svoje nasljeđe i barem povremeno praktikuju, bilo će u Crnoj Gori.

Do avgusta ove godine Maslinada uživa preventivnu, a od avgusta, nadamo se, imaće trajnu zaštitu. Njeni podzidi i međe su dio najvažnijih tradicionalnih graditeljskih struktura Maslinade. Suvozida u Maslinadi je zaista mnogo. Različitog su izgleda, visine, dužine i stanja očuvanosti, ali je onih koji ih znaju načiniti ili popraviti (sanirati) - malo, zaista malo. Tačnije, broj Ulcinjana, vlasnika maslina u Maslinadi, koji znaju kako se to radi je veliki ali je broj onih koji to znanje redovno (po potrebi) praktikuju i koji ga mogu praktikovanjem prenijeti drugima i narednoj generaciji, minimalan. Riječ je o Sabru Baljeviću jedinom graditelju suvomeđa koji to svakodnevno i profesionalno radi. Graditeljstvo i rad kamenom je njegova profesija.

Upoznavanje sa značajem suvozida za agrikulturu i agrikulturne pejzaže, ukazivanje na loše stanje tog oblika graditeljske baštine u Maslinadi te činjenica da se znanje i umijeće njihove izrade reprodukuje u premalom broju slučajeva u Crnoj Gori, te mogućnost da se takvo stanje unaprijedi su najveći uspjesi Škole suvozida. Mogućnost dokumentovanja (foto i video) gradnje i sanacije suvozida pomaže završetku procesa utvrđivanja kulturno-istorijskih i etnografskih vrijednosti dobra Građenje suvomeđa u Crnoj Gori. Škola suvozida je proizvela i desetine metara novoizrađene suvomeđe, obnovu desetak oburdanih manjih djelova ("grla") suvomeđa, jednog stepenišnog prolaza, poznanstvo sa članovima lokalne zajednice i zadovoljstvo rada u prostranom i drevnom maslinjaku Nijaza Molabećirovića. Maslinada je najprostraniji poligon za Školu suvozida. Ako bi se lokalno stanovništvo u većem broju zainteresovalo za očuvanje i obnovu njenih suvozida, bila bi to duga i uzvraćena ljubav.

Okupljeni polaznici škole, znalci i laici su od petka do nedjelje bili zajedno. Davali su ili uzimali teoretski i praktično, poduke i pouke o umijeću građenja "u suvo". Veliki dio toga znanja je ostao ali umnožen i unaprijeđen u Ulcinju. Ne mogu se požaliti na usvojeno znanje ni Herceg Novi, Kotor, Tivat, Bar, Podgorica, Nikšić, Berane, Bijelo Polje, Zeta, Cetinje i drugi gradovi i opštine iz kojih su došli učesnici škole. Svi polaznici prve generacije ulcinjske Škole suvozida mogu se smatrati i njenim osnivačima što ih dodatno obavezuje da ostanu posvećeni očuvanju i prenošenju stečenog znanja o građenju suvomeđa.

Uvjerena da dijelim mišljenje ostalih učesnika Škole, njenim organizatorima i finansijerima, medijima i drugima, od svega srca iskrena zahvala i komplimenti za sve što su učinili ili doprinose njenom uspjehu i rezultatima. Uspjeh i rezultati prve ulcinjske Škole suvozida su i preporuka za nove organizacije škole, ne samo sljedeće godine već cijele decenije. U toj i svakoj sličnoj aktivnosti koja, između ostalog, ima za cilj unapređenje stanja i veće vidljivosti crnogorskog materijalnog i nematerijalnog kulturnog nasljeđa, služba zaštite će rado učestvovati, đe god da se naše nasljeđe nalazi ili praktikuje.

Tanja Vujović, etnološkinja





Pothuajse dy mijë vjet më parë u mboll ulliri i parë në Valdanos. Më i vjetër se ullinjtë e këtij qyteti është vetëm Qyteti i Vjetër i Ulqinit. Më shumë se gjashtëdhjetë breza ulqinakësh, paraardhës të pronarëve të sotëm, mbollën dhe mirëmbajtën çdo trung, çdo kazan e tufë ullinjsh, hapën e pastruan tokën, rrafshuan taracat, ndërtuan mure të thata, hapën kanale kulluese dhe ruanin rendin e zakonin në ullishtë. Më vonë, ullishtat fituan rrugë më të gjera, më të pastra e të thata të shtruara me gurë, kanale të shtruara me pllaka dhe çezmat nga bamirësit. Çdo brez i ri trashëgonte njohuritë dhe aftësitë e mëparshme dhe i përmirësonte ato me njohuri të reja. Në dekadat e fundit kemi filluar të harrojmë dhe kemi holluar fijet që na lidhin me vlerat dhe arritjet e paçmueshme të trashëgimisë sonë. Hapësirën legjendare e përrallore, por edhe reale të Ullishtës së Ulqinit ende e mbajnë në këmbë kilometra rrugësh e shtigjesh të vjetra, mure të thata, mure mbajtëse, kanale dhe rrugë të shtruara me gurë, të bëra me duar të zhveshura dhe vegla të thjeshta nga ata që trashëguan dhe u përcollën pasardhësve njohurinë dhe mjeshtërinë e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Me teknikën e murit të thatë (ndërtim me gur pa llaç lidhës), duke përdorur gurë të patrajtuar, të prerë apo të gdhendur, janë ndërtuar objekte të shumta në të gjitha qytetërimet e kaluara në trojet malazeze dhe mesdhetare, përkatësisht në çdo tokë që është e pasur me gurë, shpesh i vetmi material ndërtimi. Kjo teknikë ndërtimi është ruajtur më së gjati në ndërtimin e shtëpive njëkatëshe me një dhomë, kasolleve, staneve në katunde malore, pojatave, tempujve, strehëve të tjera të thata dhe objekteve të ngjashme. Ato përfaqësojnë edhe sot trashëgiminë ndërtimore tradicionale malazeze, ashtu si edhe monumentet e varreve, lëmenjtë, cisternat (bunarët), ublat, puset, shkallët dhe objekte të tjera ekonomike e ndihmëse. Teknika e murit të thatë është praktikuar në mënyrë të veçantë dhe nuk është braktisur kurrë plotësisht në ndërtimin e rrugëve, kufijve (mureve ndarëse), gardheve, kalimeve, urave dhe objekteve të tjera të lidhura drejtpërdrejt me jetën dhe veprimtarinë ekonomike tradicionale.

Që nga viti 2019 është marrë Iniciativa për mbrojtjen e pasurisë kulturore “Ndërtimi i mureve të thata”. Pasi që është pranuar iniciativa, nuk është ecur më tej, sepse nuk ka qenë e mundur të dëshmohon bartësit e traditës dhe praktikuesit e trashëgimisë së gjallë të kësaj pasurie kulturore, të cilët e konsiderojnë këtë dituri si trashëgimi të tyre dhe e praktikojnë atë here pas here, kudo në Malin e Zi.

Deri në gusht të këtij viti, Ullishta gëzon mbrojtje parandaluese, ndërsa nga gushti, shpresojmë, do të ketë mbrojtje të përhershme. Muret e saj mbajtëse dhe muret ndarëse janë pjesë e strukturave më të rëndësishme ndërtimore tradicionale të Ullishtës. Mure të thata në Ullishtë ka me të vërtetë shumë.

Ato kanë pamje, lartësi, gjatësi dhe janë të ruajtura në gjendje të ndryshme, por numri i atyre që dinë t'i ndërtojnë apo t'i riparojnë (sanojnë) është i pakët, vërtet i pakët. Më saktësisht, numri i ulqinakëve, pronarë të ullinjve në Ullishtë, që dinë se si bëhet kjo është i madh, por numri i atyre që këtë ditori e praktikojnë rregullisht (sipas nevojës) dhe që mund t'ua përcjellin të tjerëve dhe brezit të ardhshëm përmes praktikimit, është minimal. Fjala është për Sabri Baljeviqin, të vetmin ndërtues muresh të thata, i cili e bën këtë çdo ditë dhe në mënyrë profesionale. Ndërtimi dhe punimi me gur është profesioni i tij. Njohja me rëndësinë e mureve të thata për bujqësinë dhe peizazhet bujqësore, tërheqja e vëmendjes për gjendjen e keqe në të cilën ndodhet kjo formë e trashëgimisë ndërtimore në Ullishtë, si dhe fakti se njohuria dhe mjeshtëria e ndërtimit të tyre riprodhohet në një numër shumë të pakët rastesh në Malin e Zi, bashkë me mundësinë që kjo gjendje të përmirësohet, janë sukseset më të mëdha të Shkollës së murit të thatë.

Mundësia e dokumentimit (foto dhe video) të ndërtimit dhe sanimit të mureve të thata ndihmon në përfundimin e procesit të përcaktimit të vlerave kulturore-historike dhe etnografike të pasurisë "Ndërtimi i mureve të thata" në Malin e Zi. Shkolla e murit të thatë ka prodhuar gjithashtu dhjetëra metra mure të thata të reja, rindërtimin e rreth dhjetë pjesëve të vogla të shembura të mureve të thata, një kalim me shkallë, njohjen me anëtarët e komunitetit lokal dhe kënaqësinë e punës në ullishtën e gjerë dhe të lashtë të Nijaz Mollabeqirit. Ullishta është poligoni më i gjerë për Shkollën e murit të thatë. Nëse popullsia vendase do të interesohej në numër më të madh për ruajtjen dhe përrirjen e mureve të saj të thata, kjo do të ishte një dashuri e gjatë dhe e ndërsjelltë.

Pjesëmarrësit e mbledhur të shkollës, njohës e laikë, ishin së bashku nga e premta deri të dielën. Ata dhanë ose morën, në mënyrë teorike dhe praktike, udhëzime dhe mësim mbi mjeshtërinë e ndërtimit "në të thatë". Një pjesë e madhe e kësaj diturie mbeti, por e shumëfishuar dhe e përmirësuar në Ulqin. Të gjithë pjesëmarrësit e brezit të parë të Shkollës së murit të thatë të Ulqinit mund të konsiderohen edhe si themelues të saj, gjë që i obligon ata shtesë të mbeten të përkushtuar ndaj ruajtjes dhe përcjelljes së njohurive të fituara për ndërtimin e mureve të thata.

Suksesi dhe rezultatet e Shkollës së parë të murit të thatë në Ulqin janë gjithashtu një rekomandim për organizime të reja të shkollës, jo vetëm vitin e ardhshëm, por gjatë gjithë dekadës. Në këtë dhe në çdo aktivitet të ngjashëm që, ndër të tjera, ka për qëllim përmirësimin e gjendjes dhe rritjen e dukshmërisë së trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale të Malit të Zi, shërbimi i mbrojtjes do të marrë pjesë me kënaqësi, kudo që të ndodhet apo të praktikohet trashëgimia jonë.



*Iz Martine perspektive – jedan dan Škole suvozida
Skica: Marta Perović, 5 godina*

*Nga këndvështrimi i Martës – një ditë në Shkollën e murit të thatë
Skicë: Marta Perović, 5 vjeçe*